



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Uprava za Opštu Administraciju

Directory of General Administration

Raporti i punës për periudhën janar - mars 2025

Raporti është i bazuar në planifikimin, objektivat dhe detyrat e punës së zyrtarit për Barazi Gjinore


- Mbledhja e parë si antarë i KKSBB-së për vitin 2025.
- Plotësim i pyetesorit kërkuar nga MAPL për pjesën e barazisë gjinore.
- Agjencia për Barazi Gjinore në bashkëpunim me Zyrën e UN Women Kosovë organizoi punëtorin me qëllim të mbështetjes në hartimin, rishikim dhe koordinim në zbatim të aktiviteteve të parapara në planet vjetore të punës për Zyrtarët/et për Barazi Gjinore (ZBGJ) në nivelin komunal.
- Pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit për përgatitjen e procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave.
- Njoftim përmes e-mailit, i deklarimit të dhuratave për të gjithë drejtorët e drejtorive dhe punëtorët komunalë.
- Takim me kryetarin dhe grupin e performancës komunale, ku u diskutua për raportimin e të dhënave në sistem për vitin 2024.
- Pjesëmarrës në takimin e organizuar nga Organizata Medica Kosova në kuadër të projektit "Të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës dhe të dhunës në familje kanë qasje të përmirësuar në shërbime sociale dhe mbrojtje institucionale" të financuar nga Ministria e Drejtësisë.
- U mbajt Punëtorja për zhvillimin e Planit të Veprimit në komunën e Rahovecit, aktivitet i organizuar nga Rrjeti Qeliza për anëtarët e Mekanizmit Koordinues Komunal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ku u diskutuan arritjet si dhe rekomandimet për punën e mëtejshme të këtij plani.
- Pjesëmarrës në trajnimin e organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temën "Hartimi i dokumenteve strategjike Lokale" nga fusha Çështje Komunale.
- Marrja pjesë në tryezën e diskutimit organizuar nga Helvetas/DEMOS dhe Instituti GAP me temën "Avancimi i integritetit gjinor në komunat e Kosovës: Këndvështrim i politikave".

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme

- Aktivitete me rastin e 8 Marsit ditës ndërkombëtare të gruas:
Pjesëmarrës në marshin paqësor organizuar nga shoqata "Hareja" me moton "Marshojmë s'festojmë", ku bëmë ecje nëpër qytet.
Po ashtu, shoqata "Hareja" së bashku me zyren për Barazi Gjinore organizoi një tryezë të rrumbullakët me gratë me temën "Krenare që jam grua", ku gratë në pozita udhëheqëse kanë rrëfyer për sfidat dhe të arriturat në jetën e tyre. (pjesëmarrëse ishin 25 gra dhe 2 burra).
- Plotësim i pyetësorit dërguar nga Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Agjencinë për Barazi Gjinore/ZKM dhe UN Women Kosovë të cilët kanë realizuar një pyetësor si pjesë të analizës sektoriale të reformës në administratë publike. Ky pyetësor është në kuadër të projektit Instrumenti për Barazi Gjinore "Gender Equality Facility" (GEF) i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian dhe i zbatuar nga UN Women.
- Pjesëmarrës në punëtorinë me temë "Mbrotja e të dhënave personale në sistemin shëndetësor", kjo punëtori u organizua nga Agjencia për Informim dhe Privatësi mbështetur nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë Misioni në Kosovë - OSBE.
- Marrja pjesë në trajnimin dy ditor 18-19 mars, organizuar nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) me temën: "Të drejtat e komuniteteve në Kosovë".
- Mbledhja e dytë e rregullt e KKSB-së.
- Instituti i Kosovës për Administratë Publike (IKAP) organizoi trajnimin "Çështjet gjinore dhe sfidat e ndërtimit të barazisë gjinore" nga fusha Çështje Komunale për zyrtarët profesional, trajnimi u mbajt me 25 dhe 26 mars.
- Plotësim i pyetësorit për Barazi Gjinore, me kërkesë të Administratës publike.
- Si punë shtes me vendim të kryetarit:
Njoftimi për deklaram të pasurisë përmes e-mailit për personat zyrtarë që kanë për të deklaruar pasurinë si deklarim i rregullt për vitin 2024.

Alban Gashi



**Zyrtar për Barazi Gjinore
Komuna Rahovec**

04.04.2025

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria për Administratë të përgjithshme